



KPM-2018/02

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6 dhe 2.11, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM miraton këtë:

DRAFT RREGULLORE PËR PRONËSINË DHE KONCENTRIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIOVIZUALE

NENI 1 QËLLIMI

Kjo Rregullore ka për qëllim vendosjen e standardeve lidhur me pluralizmin dhe diversitetin mediatik dhe transparencën në pronësinë e mediave, duke përcaktuar rregullat për koncentrimin e pronësisë në media, parandalimin e monopolit në tregun medial, ndalimin e dominimit dhe presionit mbi mediumet, lirinë e shprehjes, ruajtjen e pavarësisë editoriale dhe të drejtën e informimit objektiv në harmoni me legjislacionin vendor si dhe praktikatat më të mira evropiane.

NENI 2 FUSHËVEPRIMI

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen ndaj të gjithë të licencuarve të KPM-së të cilët ushtrojnë aktivitete të ofrimit të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale në Republikën e Kosovës.

NENI 3 PËRKUFIZIMET

- Ofruesi i shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA)** - personi fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes së programeve audio apo audiovizuale të shërbimit mediatik audiovizual dhe i cili përcakton mënyrën se si ato do të organizohen. ndryshon pak nga përkufizimi në Ligj.
- Shërbimi medial audiovizual (SHMA)** - shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i së cilës është ofrimi i programeve me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.

3. **Operatori i shpërndarjes** – personi juridik i cili shpërndan shërbime mediale audio dhe audiovizuale për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV, OTT, satelitor dhe çfarëdo forme tjetër të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv tokësor.
4. **Mediat e shkruara** – botimet e nxjerra në formë të revistave, gazetave, dorëshkrimeve dhe formave tjera të shkruara.
5. **Portalet e lajmeve:** platformat online të ofrimit të lajmeve me përmbajtje tekstuale dhe audiovizuale nën përgjegjësinë redaktuese të ofruesit të këtij shërbimi, të cilat kanë për qëllim informimin dhe janë të qasshme për publikun e gjerë.
6. **Koncentrimi i pronësisë në media** - një industri ku disa individë ose organizata kontrollojnë aksione të ndryshme në ofruesit e shërbimeve mediale të caktuara. Në terma më të gjera koncentrimi tregon nivelin e konkurrencës në një industri.
7. **Licencë** – është leje kontraktuale e dhënë nga KPM-ja për transmetime radio-televizive dhe shërbime mediale audiovizuale. Licenca e obligon të Licencuarin që të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së dhe ligjet tjera relevante të zbatueshme në Republikën e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e KPM-së si dhe kushtet dhe termat e përgjithshme të Licencës së KPM-së.
8. **I licencuar** - Nënkupton subjektin të cilit KPM-ja i ka dhënë Licencën dhe të drejtën e shfrytëzimit të frekuencës, të drejtën për të ofruar shërbime programore dhe ritransmetim të programeve radio-televizive përmes operatorëve të rrjetit.
9. **Pronësia** - Zotërimi i ofruesit të shërbimit medial audio dhe audiovizual i më shumë se 10% të pjesës së kapitalit bazë të një shërbyesi medial audiovizual dhe/ose të pajisjeve të tij.
10. **Programi gjeneralistik** - ofruesi i shërbimit medial që përbëhet nga lajmet, diskutimet dhe intervistat për çështjet me interes publik, programet edukative aktuale për të rriturit ose fëmijët që kanë nevojë për përkrahje ose ndryshojnë bindje për tema ose modele, argëtime për fëmijë me tema edukative, dokumentarët, programet kulturore, qëllimi kryesor i të cilave është të informojnë e jo të argëtojnë.
11. **Kanal tematik** - ofruesi i shërbimit medial, programi i të cilit përmban 70% të një lloji të caktuar programor si: informativ, edukativ, argëtues, për fëmijë, sportiv, shkencor etj.

NENI 4

RREGULLIMI I PRONËSISË SË OSHMA-ve

1. Personi fizik ose juridik, që ka licencë në nivel nacional transmetimi audio ose audiovizual, nuk mund të ketë më shumë se 10% të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që ka një licencë për mbulim nacional të transmetimit audio ose audiovizual. Për transmetimet audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10% në një person fizik apo juridik. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio ose audiovizual me mbulueshmëri regjionale ose lokale.

2. Bashkimi ose shkrirja e dy ose më shumë ofruesve të shërbimit medial në nivel nacional ndalohet me këtë rregullore.
3. Asnjë i licencuar me mbulueshmëri nacionale audio dhe audiovizuale nuk mund të transmetojë më shumë se 30% të vlerës së tregut të përgjithshëm medial të komunikimeve komerciale audiovizuale.
4. Një person fizik ose juridik, që ka 100% të aksioneve në një shoqëri që ka një licencë transmetimi audiovizuale regjionale ose lokale, mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim audio regjionale ose lokale. Në rast se personi fizik ose juridik operon në të njëjtin regjion, nuk mund të ketë më shumë se një licencë për program gjeneralistik.
5. Një person fizik ose juridik që ka 100% të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio regjionale ose lokale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizuale regjionale ose lokale. Në rast se personi fizik ose juridik operon në të njëjtin regjion, nuk mund të ketë më shumë se një licencë për program gjeneralistik.
6. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që ka një licencë transmetimi audiovizuale regjionale ose lokale nuk mund të ketë më shumë se 40% të kapitalit të përgjithshëm në një OSHMA dytë që zotëron një licencë transmetimi audiovizuale regjionale ose lokale. Vlera e aksioneve në të dy OSHMA-të nuk mund të kalojë 50% të totalit të aksioneve të përgjithshme.
7. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që ka një licencë transmetimi audio regjionale ose lokale, nuk mund të ketë më shumë se 40% të kapitalit të përgjithshëm në një OSHMA të dytë, që zotëron një licencë transmetimi audio regjionale ose lokale.
8. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe subjektet juridike të autorizuara për ofrimin e shërbimeve audio dhe audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes.
9. Personi fizik dhe juridik mund të zotërojë dy licenca për transmetim audiovizual në të njëjtën zonë mbulimi, me kusht që të dy OSHMA-të të kenë përmbajtje të ndryshme programore, njëra e karakterit gjeneralistik tjetra e atij tematik.
10. Personi fizik dhe juridik mund të zotërojë dy licenca për transmetim audio në të njëjtën zonë mbulimi, me kusht që të dy OSHMA-të të kenë përmbajtje të ndryshme programore, njëra e karakterit gjeneralistik dhe tjetra e atij tematik.
11. Personi fizik dhe juridik mund të zotërojë dy licenca për transmetim, njëra për audio dhe tjetra audiovizuale në të njëjtën zonë mbulimi.
12. Personi fizik dhe juridik i cili ka licencë në nivel nacional nuk mund të ketë edhe një pjesë të aksioneve që tejkalojnë 10% të kapitalit të personit juridik që kryen aktivitetin e një agjensie në fushën e mediave, dhe anasjelltas.

13. Personi fizik dhe juridik që ka licencë në nivel nacional nuk mund të ketë një pjesë që e tejkalon 10% të kapitalit të botuesit që boton gazetë të përditshme të shtypur në më shumë se 3000 (tremijë) kopje, dhe anasjelltas.
14. Personi fizik dhe juridik që ka licencë me mbulim regjional dhe lokal nuk mund të ketë në pronësi gazeta ditore me rëndësi lokale në të njëjtën zonë mbulimi.
15. Personi fizik dhe juridik që ka licencë për mbulim në nivel regjional apo lokal nuk mund të ketë një pjesë që e tejkalon 10% të kapitalit të të një gazete të përditshme me rëndësi lokale në të njëjtën zonë apo në një zonë pranë.
16. Personi fizik dhe juridik që ka licencë për OSHMA audio dhe audiovizual me mbulim në nivel nacional nuk mund të ketë një pjesë që e tejkalon 10% të kapitalit të botuesit të një portali me përmbajtje gjeneralistike që vizitohet mesatarisht nga më shumë se 3000 (tremijë) vizitorë ditor.

NENI 5 PRONËSIA E SHUMËFISHTË

1. Një person fizik ose juridik nuk mund të zotërojë më shumë se tri licenca regjionale ose lokale, që mbulojnë dy zona të ndryshme, prej të cilave jo më shumë se dy mund të jenë ofrues audiovizual. Brenda një zone të mbulimit nuk mund të jetë më shumë se një OSHMA me përmbajtje gjeneralistike.
2. Një person fizik ose juridik mund të zotërojë vetëm tri licenca regjionale ose lokale, në dy zona të ndryshme, me kusht që në secilin regjion vetëm një mund të jetë me përmbajtje gjeneralistike dhe përmbajtja të jetë specifike/e ndryshme për secilën zonë.
3. Një person fizik ose juridik mund të zotërojë dy ofrues audio në një zonë mbulimi, në rast që e njëjta zonë mbulimi mbulohet nga një ose më shumë ofrues tjerë audio.
4. Nuk do të aplikohen kurrfarë kufizimesh për pronarët e vetëm një ofruesi audio ose audiovizual në zonat që nuk janë zona tregu. Pronësia e transmetuesve të shumëfishtë që shërbejnë në zonat e njëjta të pa mbuluara është e ndaluar përveç nëse zona e njëjtë është e mbuluar nga një apo më shumë transmetues të ndryshëm.
5. Personi fizik dhe juridik me mbulim nacional mund të zotërojë jo më shumë se edhe një ofrues audio që mbulon dy zona të ndryshme dhe jo më shumë se një ofrues audiovizual që mbulon një zonë lokale, duke siguruar që asnjëra nuk është ofrues audio apo audiovizual i vetëm në zonën përkatëse.
6. Përveç në raste të veçanta, kur kërkohet me rregulla teknike dhe/ose në pajtim me obligimet ndërkombëtare, KPM do të lëshojë një licencë me të cilën ofruesit e shërbimit medial të caktuar do të mbulojnë zonën e njëjtë prej pozitive dhe frekuencave të ndryshme.
7. Obligimet e parapara me këtë nen i dedikohen ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuel me karakter gjeneralistik.

NENI 6 PRONËSIA E HUAJ

1. Pronësia e huaj e një OSHMA-je lejohet vetëm në rastin e kompanive komerciale të regjistruara ligjërisht në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Rregullat mbi koncentrimin e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale vlejné përshtatshmërisht edhe për personat fizik ose juridik të huaj.

NENI 7 NDALESAT PËR PRONËSINË E OSHMA-ve

1. Licenca e transmetimit nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdoj t'i jepet:
 - 1.1 Partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individ i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike;
 - 1.2 Personit juridik i cili menaxhohet nga një individ, i cili është i dënuar në një proces në përputhje me standardet ndërkombëtare, për krime që kanë të bëjnë me dhunë apo mashtrime, të cilat nuk i janë falur ligjërisht atij ose asaj.

NENI 8 PERSONAT E LIDHUR ME OSHMA-të

1. Ndalesat e përcaktuara në këtë Rregullore për pronarët e një ofruesi audio ose audiovizual vlejné edhe për personat e lidhur me ta, siç janë:
 - 1.1 Të afërmit e gjakut, pjesëtarët e familjes së ngushtë (prindërit, fëmijët, vëllezërit dhe motrat, adoptuesit dhe të adoptuarit);
 - 1.2 Personat nga bashkësia martesore ose jashtëmartesore;
 - 1.3 Anëtarët e familjes së afërt të bashkëshortit;
 - 1.4 Personat të cilët mbajnë një pjesë të përgjithshme të biznesit, aksione ose të drejta të tjera në bazë të të cilave ata marrin pjesë në menaxhimin e një OSHMA-je.
 - 1.5 Personat të cilët janë anëtarë të bordit drejtues ose mbikëqyrës në një OSHMA si dhe personat që konsiderohen të jenë të lidhur me kryetarët e drejtorisë ose bordit mbikëqyrës të asaj OSHMA-je.

NENI 9
TË DREJTAT DHE OBLIGIMET

1. Ofruesi i shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale obligohet që brenda pesë (5) ditëve të punës të njoftojë me shkrim në KPM për ndryshimet në strukturë organizative dhe të pronësisë.
2. Për çdo ndryshim në pronësi nga ofruesi i shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale me mbi 10% kërkohet paraprakisht aprovim nga KPM-ja.
3. Ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale obligohen ta njoftojnë KPM-në për aspekte të veçanta rreth pronësisë dhe strukturës organizative të tyre sa herë që KPM-ja do të kërkojë një gjë të tillë.
4. Ofruesi i shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale do të deponojë njëherë në vit raport me të dhëna për aspekte të pronësisë, strukturës organizative dhe financiare.

NENI 10
SANKSIONET

Për mosrespektim të kësaj Rregulloreje do të aplikohen sanksionet e përcaktuara me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

NENI 11
HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Muja FERATI
Kryetar i Komisionit të Pavarur të Mediave

Datë